

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

19 janar 2012  
Ap - Kz 297/10

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegit, Gjyqtaren e Gjykatës Supreme Nesrin Lushta dhe Gjyqtarin e EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si anëtarë të kolegit, të ndihmuar nga Zyrtarja ligjore Chiara Rojek si Procesmbaitëse.

I akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorit Publik të EULEX-it PP nr. 72/2008 të paraqitur më 15 qershor 2009, për veprat penale Vrasje e rëndë në kundërshtim të nenit 147 pikës 4 të Kodit të Përkoħshem Penal të Kosovës (KPPK-së); Vrasje në tentativë në kundërshtim të nenit 146 në lidhje me nenin 20 të KPPPK-së; dhe Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK- së.

I dënuar me aktgjykimin P nr. 02/2010 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 5 korrik 2010, për veprat penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve; dhe është shpallur se nuk ka përgjegjësi penale për veprat penale Vrasje e rendë në kundërshtim të nenit 147 pikave 4 dhe 11 të KPPK-së për shkak të paftësisë mendore sipas nenit 12 paragrafit 1 të KPPK-së.

Duke vendosur në lidhje me ankesën e paraqitur më 6 shtator 2010, nga avokati Miodrag Brkljac, përfaqësues i palës së dëmtuar Z M kundër aktgjykimit P.nr. 02/2010 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, të datës 5 korrik 2010, dhe duke marr parasysh përgjigjen në ankesë të paraqitur më 20 shtator 2010 nga avokati mbrojtës Rexhep Kaçaniku në emër të pandehurit D D, dhe mendimit mbi ankesën të paraqitur më 29 dhjetor 2010 nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSH-K-së).

Pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 19 janar 2012, sipas neneve 410 dhe 422 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), lëshon këtë:

AKTIVENDIM

Ankesa e paraqitur më 6 shtator 2010 nga avokati Miodrag Brkljac në dobi të palës së dëmtuar Z M kundër aktgjykimit P nr. 02/2010 të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë të datës 5 korrik 2010, HEDHET POSHTË si palejueshme.

## **I. Historia e Procedurës**

Aktakuza PP nr. 72/08, e datës 11 qershor 2009 është paraqitur pranë shkrimores nga Prokurori i EULEX-it më 15 qershor 2009, duke e akuzuar të pandehurin D D si më lartë.

Më 18 nëntor 2009, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it ka lëshuar një vendim për marrjen e lëndës nga Gjyqtarët e EULEX-it sipas nenin 3.3 të Ligjit mbi kompetencat<sup>1</sup> dhe lëndën ia ka caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it.

Më 25 janar 2010, aktakuza është konfirmuar në tërësi me aktvendimin KA nr. 40/08 - PP nr. 72/08.

Seancat gjyqësore janë mbajtur në publik më 15, 19, 28 prill, 24 qershor dhe 5 korrik 2010.

Më 5 korrik 2010, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë ka shpallur aktgjykimin. I pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të KPPK-së, dhe është dënuar me dy (2) vite burgim sepse ka pasur në posedim një armë AK-47, prodhim Jugosllav, AB-2, kalibrit 7.62x39mm me numër serik C-50588 pa leje të vlefshme për një periudhë kohore të panjohur deri më 18 qershor 2008. Gjykata e shkallës së parë ka urdhëruar që koha e kaluar në paraburgim prej 19 qershorit 2008 të llogaritet sipas nenit 73 paragrafit (1) të KPPK-së, dhe në të njëjtën ditë ka lëshuar aktvendimin mbi ndërprerjen e menjëhershme të paraburgimit.

Për më tepër, gjykata e shkallës së parë ka vendosur që D D ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë në kundërshtim të nenit 147 pikave 4 dhe 11 të KPPK-së, “[...] sepse më 18 qershor 2008, rrëth orës 23:00, në Zubin Potok, në rrugën Arsenije Carnojevic, nga shtëpia e tij i akuzuari D D në gjendje të përkohshme të çrrëgullimit mendor si reagim psikik paranoik, ka shtënë disa herë nga një pushkë gjysmë automatike AK-47, prodhim Jugosllav AB-2, kalibri 7,62x39 mm, me numër serik C-50558, me ç ‘rast ka vrarë R M. i cili ka gjak derdhur deri në vdekje gjatë rrugës për në spital për shkak të plagëve të shumëfishta hyrëse nga arma. I akuzuari gjithashu ka qëlluar P D i cili ka pësuar plagë nga arma e zjarrit por i cili ishte në përmirësim e sipër kur vdiq për shkak të bllokimit mushkërive nga droçka e gjakut, më 1 korrik 2008”. Megjithatë, gjykata ka gjetur se i pandehuri nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë mendore sipas nenit 12 paragrafit (1) të KPPK-së. Prandaj, Gjykata e Qarkut ka shqiptuar masën e trajtimit psikiatrik të detyrueshëm në liri sipas nenit 5 dhe nenit 12.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/34 mbi Procedurën Penale e cila përfshinë kryerës me çrrëgullime mendore.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Ligji Nr. 03/L-53 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë i datës 13 mars 2008.

<sup>2</sup> Rregullorja e UNMIK-ut 2004/34 mbi Procedurën Penale e cila përfshinë kryerës me çrrëgullime mendore e datës 24 gusht 2004.

Kërkesa pasurore e palës së dëmtuar është referuar në procedurë civile sipas nenit 112 paragrafit (3) të KPPPK-së.

Më 6 shtator 2010, ankesa është ushtruar në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut nga avokati Miodrag Brkljac, përfaqësues i palës së dëmtuar Z<sup>3</sup> M<sup>3</sup>. Avokati mbrojtës Rexhep Kaçaniku për Dragisa Djukic paraqiti përgjigje në ankesë më 20 shtator. Shkresat e lëndës janë pranuar në Shkrimoren e Gjykatës Supreme më 29 shtator 2010. Më 29 dhjetor 2010, ZPShK paraqiti mendimin për ankesën.

## ***II. Parashtresat e palëve***

### ***II.A. Ankesa e palës së dëmtuar***

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar propozon të prishet aktgjykimi dhe lënda të dërgohet mbrapa për rigjykim për shkak të shkeljes së Kodit Penal; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; për vendimin mbi sanksionet penale; dhe vendimin për kërkësen pronësore juridike. Përveç kësaj avokati Miodrag Brkljac pohon se Prokurori nuk i ka dhënë mbështetje palës së dëmtuar pasi që ajo nuk ka shpall apo paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të kontestuar. Si pasojë pala e dëmtuar lejohet të ushtroi ankesë mbi çdo bazë e jo vetëm mbi vendimin për sanksionet penale.

Në lidhje me *vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike*, avokati Miodrag Brkljac ngrit pikat në vijim: ekzistimi i motivit për të shtënë në palët e dëmtuara; gjendja mentale e të pandehurit në kohën e kryerjes së veprave penale; dhe gjuajtja e mundshme e personave të gabuar.

Sa i përket motivit dhe gjendjes mentale të D<sup>1</sup> D<sup>2</sup>, pala e dëmtuar thekson se ekspertët e kanë pranuar sqarimin e fakteve të të pandehurit dhe duke vepruar në këtë mënyre kanë arritur në konkluzion të gabuar. Një ekspertizë plotësues sikurse është propozuar gjatë seancës së gjykimit, është dashur të mbahej. Avokati po ashtu kundërshton saktësinë e deklaratës së D<sup>1</sup> D<sup>2</sup> pasi që është mbështetur vetëm nga S<sup>1</sup> D<sup>2</sup>. Përveç kësaj, ekspertët nuk kanë pyetur nëse i pandehuri e ka ditur se është duke gjuajtur në drejtim të viktimate dhe gabimisht kanë nxjerr konkluzionin se i pandehuri nuk e dinte çfarë ishte duke bërë.

Në lidhje me *vendimin për sanksionet penale*, përfaqësuesi i palës së dëmtuar pohon se dënimimi me dy vjet burgim për Posedim të Paautorizuar të Armëve kishte qëllimin e ‘mbulimit’ të kohës së kaluar në paraburgim. Sipas mendimit të tij, shqiptimi i dënimive më të ashpra duhet të dekurajoj kryerësit potencial nga përdorimi i armëve të zjarrit. Një dënim më i butë i burgimit është dashur të shqiptohet për dy pikat e Vrasje e Rëndë sepse me siguri D<sup>1</sup> D<sup>2</sup> ishte në gjendje të dobët të kapacitetit mendor në kohën përkatëse (jo i sëmurë mental i përkohshëm). Gjithashtu nuk ka pasur hapësirë për trajtim në liri dhe në fund të fundit, i pandehuri është dashur të vendosjet në Klinikën Psikiatrike në Prishtinë. Në fund gjykata e shkallës së parë ka neglizhuar se familja M<sup>1</sup> jeton në

<sup>3</sup> Ditën tjeter avokati Miodrag Brkljac ushtroi një shtojcë në ankesën me të cilën ai kërkoi që të njoftohet për datën dhe kohën e seancës së apelit.

lagjen ku është shtëpia e të pandehurit dhe se ky kontakt pamor ka mundur të shpie në aktin e hakmarjes.

Në lidhje me *kompensimin e kërkesës pasurore juridike*, avokati Miodrag Brkljac pohon se çështja e përgjegjësisë penale drejtpërdrejtë është e lidhur me vendimin për sanksionet penale dhe kërkesën pasurore juridike. Ai kundërshton qëndrimin e Gjykatës se i pandehuri nuk mund të detyrohet me forcë që të kompensojë dëmin që ia ka shkaktuar palës së dëmtuar siç përcaktohet me Nenin 112 të KPPK-së, pasi që ai nuk ka përgjegjësi penale për veprën e vet.

#### **B. Përgjigje në Ankesën e Palës së Dëmtuar**

Avokati mbrojtës për D D i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që të refuzojë ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar si të papranueshme, përvèç shkaqeve të cilat lidhen me vendimin mbi dënimin, dhe që të refuzojë pjesën tjetër si të pabazë. Ai thekson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt gjendjen faktike dhe me të drejtë ka vepruar kur ka emëruar ekspertët e licencuar me qëllim të vlerësimit të gjendjes mendore të të pandehurit. Sipas mendimit të mbrojtjes, dënnimi prej dy (2) vjet burgimi për këtë vepër penale është dënnimi më i gjatë i cili është shqiptuar ndonjëherë në një gjykatë kosovare. Mbrotja pohon që D D nuk ka treguar asnjë shenjë të sjelljes së dhunshme prej kur është paraburgosur, dhe se madje edhe sot e kësaj dite D D nuk del nga shtëpia, përvèç kur i duhet të shkojë në shtëpinë e shëndetit në . Duke pasur parasysh se nga njëra anë kërkesa pasurore nuk është vërtetuar me dokumente të besueshme si dhe nga ana tjetër fakti që i pandehuri nuk ka qenë i aftë nga aspekti mendor, atëherë vendimi i gjykatës së shkallës së parë mbi kërkesën pasurore është i arsyetuar mirë.

#### **C. Mendimi i ZPShK-së**

Në përgjigjen e vet, Prokurori i Shtetit i sugjeron Gjykatës Supreme që të hedhë poshtë Ankesën si të paafatshme dhe të papranueshme pasi që e njëjtë është paraqitur nga personi i paautorizuar në përputhje me Nenin 420, par. 1, nënpar. 1 të KPPK-së.

Lidhur me *Ankesën e ushtruar kundër aktvendimit me të cilin është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri*, ZPShK-ja pohon se Ankesa është e paafatshme dhe e papranueshme pasi që e njëjtë është paraqitur nga personi i paautorizuar siç përcaktohet me Nenin 33.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/34, në kuptim të Nenit 420 të KPPK-së. Në bazë të Nenit 12.4 të Rregullores së cekur më lart, Ankesa e palës së dëmtuar kundër këtij aktvendimi nuk është e autorizuar dhe se ankesa duhet patjetër që të paraqitet brenda tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. Pasi që vendimi i është dorëzuar palës së dëmtuar më datën 17 gusht (Përfaqësuesit të palës së dëmtuar më 24 gusht), ndërsa ankesa është ushtruar më datën 6 shtator, atëherë afati ligjor nuk është respektuar. Për më tepër, Prokurori i Shtetit konsideron që vendimi i gjykatës së shkallës së parë për urdhërimin e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik është i drejtë.

Sa i përket *Ankesës kundër Aktgjykit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë*, në pikëpamjen e Prokurorit të Shtetit, Ankesa është e paafatshme dhe e papranueshme, pasi që e njëjtë është paraqitur nga personi i paautorizuar në bazë të Nenit 420 të KPPK-së

dhe nuk respekton afatin ligjor të përcaktuar me Nenin 398 të KPPK-së. ZPSHk-ja më tej pohon se Z. M. nuk është palë e dëmtuar lidhur me shkeljen me armë në kuptim të Nenit 399, par. 3 të KPPK-së. Po qe se Gjykata Supreme e shpall ankesën të lejueshme, Prokurori i Shtetit konsideron se dënim i shqiptuar është i drejtë dhe proporcional me veprën penale dhe se Gjykata e Qarkut me të drejtë ka marrë parasysh rrethanat përkatëse qoftë ato lehtësuese qoftë ato rënduese. Përfundimisht, ZPSHk-ja pajtohet me vendimin e gjykatës së shkallës së parë për ta referuar lëndën për zgjidhje civile të kontestit në përputhje me Nenin 112 të KPPK-së.

### *III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës*

#### *A. Kompetenca dhe procedura para Gjykatës Supreme të Kosovës*

Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente të vendos mbi ankesën në pajtim me Nenet 26 Paragrafin 1 dhe 398 dhe vijues të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është themeluar në pajtim me Nenin 3 Paragrafit 7 të Ligjit nr. 03/L-53 mbi Kompetencat. Kolegji i Gjykatës Supreme ka mbajtur seancë më 19 janar 2012.

#### *B. Lejueshmëria e ankesave të parashtruara nga pala e dëmtuar*

Aktgjyki është i datës 02/2010, që shpallur nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë me datën 5 korrik 2010.

Me letërën e datës 7 korrik 2010, përfaqësuesi i palës së dëmtuar Z. M. ka paralajmëruar ankesë kundër aktgjykimit të kontestuar. Ai ka pranuar aktgjykimin me datën 24 gusht 2010. Është e pamundur të përcaktohet se kur iu është dërguar aktgjyki Z. M. pasi që shkresat e lëndës nuk përbajnjë asnjë fletë dërgesë. Palët tjera të dëmtuara S. dhe P. D. e kanë pranuar aktgjykimin e kundërshtuar me datën 16 respektivisht 17 gusht 2010. Ankesa e palës së dëmtuar Z. M. është parashtruar në shkrimore e Gjykatës së Qarkut më 6 shtator 2010.

Ankesa nuk është e lejueshme. Tashmë ekzistojnë dyshime lidhur me përpikërinë e këshillës juridike kundër sanksioneve pér vrasjet sipas aktakuzës. Rregullorja e aplikueshme e UNMIK-ut nr. 2004/34 lejon që ankesa të parashtrohet brenda tetë (8) ditëve nga dita e marrjes së vendimit. Por edhe në qoftë se ankesa do të pranohej pér shkak të udhëzimeve të gabueshme të gjykatës së shkallës së parë duke iu referuar afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej ditës së dorëzimit të aktgjykimit në pajtim me Nenin 389 paragrafit 1 të KPPPK-së, ankesa megjithatë është e palejueshme. Neni 12.4 i Rregullores së përmendor shprehimisht përashton të drejtën e palës së dëmtuar të parashtrojë ankesë kundër aktgjykimeve që shqiptojnë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Në bazë të raporteve të disa ekspertëve psikiatrik, Gjykata e Qarkut ka liruar të pandehurin nga akuza e Vrasjes së Rendë pér shkak të mungesës së përgjegjësisë penale, kur e ka vrarë R. M. dhe ka lënduar rëndë P. D.. I pandehuri është konstatuar me çregullime të përkohshme mentale; sëmundja e tij është përkufizuar si reagim paranoik psikik.

Përashtimi i së drejtës së palës së dëmtuar pér t'u ankuar synon shhangien e përsëritjes së marrjes së provave duke i ngarkuar kryesisht personat e sëmurë psikik. Kjo nuk mund

të shmanget duke e rishikuar vendimin duke marr parasysh shkeljet e rënda të pretenduara të procedurës penale të cilat –meqë ra fjala – nuk kanë ndodhur. Në të kundërtën Gjykata e Qarkut në mënyrë të plotë ka shqyrtuar faktet dhe rezultatet e saj nuk janë në mënyrë të dukshme të mangëta.

Ky përjashtim i së drejtës për t'u ankuar nuk e shkel Nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pala e dëmtuar nuk akuzohet me krim dhe nuk i nevojitet mbrojtje e mëtutjeshme në procedurën penale. Ai mund t'i ndjek të drejtat e tij në kontestet civile.

Gjithashtu, ankesa e palës së dëmtuar që ka të bëj me sanksionet ndëshkuese për veprën penale të Nenit 328 Paragrafit 2 të KPK-së është e papranueshme. Pala e dëmtuar nuk ka të drejtë për ankesë për shkak se ai nuk është i mbrojtur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga dispozitat penale që synojnë të shmangin keqpërdorimin e armëve. Vetëm shteti, i përfaqësuar nga prokurori duhet ta mbroj ligjin dhe rendin dhe të vëzhgoj nëse autori i krimit sanksionohet në mënyrë adekuate për veprën penale duke shkelur ligjin objektiv mbrojtës.

Vendimi i Gjykatës së Qarkut për adresimin e kërkesës pasurore të palës së dëmtuar në procedurë civile nuk është kontestues në mënyrë të ndarë. Për më tepër konstatohet e arsyeshme që ankesat civile të trajtohen në mënyrë të veçantë për shkak të mundësisë së eksplorimeve të mëtutjeshme të komplikuara nga ekspertët që do të mund të ngarkonin procedurën penale. Vërtetimi i kujdeshëm i fakteve në procedurë të ndarë do të jetë gjithashtu në dobi të palës së dëmtuar. Gjyqtari civil duhet të vendos në mënyrë të pavarur nga pikëpamja e gjyqtarit penal. Të dy procedurat ndjekin parime të ndryshme procedurale duke rezultuar në vlerësimin ndryshtë nga vlerësimi i përgjegjësisë penale.

Për shkak të papranueshmërisë së ankesës, Gjykata Supreme nuk ka mundësi të ekzaminimit të mëtutjeshëm përbajtjesor.

Ankesa duhet të refuzohet me aktvendim në bazë të Nenit 422-të KPK-së.

**Kryetar i Kolegit:**

Dr. Horst Proetel, Gjyqtar i EULEX-it

**Anëtar i kolegit:**

Gerrit-Marc Sprenger, Gjyqtar i EULEX-it

**Anëtarë e kolegit:**

SAKTESINËTË SË PUSHTETVE  
TÄCNOŠT DIPRAVKA BOTYSE

Nesrin Lushita, Gjyqtare e Gjykatës

Supreme Court of Kosovo

**Prosesmbajtëse:**

Chiara Rojek

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**

**19 janar 2012**

**Ap – Kz 297/10**

**Prishtinë**